



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME



P.A.nr.09/2026

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryetar i kolegjit, Franciska Zhitija Ymeri dhe Milena Deric anëtar të kolegjit, në çështjen juridike të konfliktit administrativ sipas padisë së paditësit: Nasuf Hasani, nga Prishtina, Rr. “Nekibe Kelmendi”, Objekti Delta Invest, Hyrja 1, kati 1, nr.4, kundër të paditurës: Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike: shfuqizimin e pjesëshëm të aktit nënligjor normativ, paragrafit 2 të nenit 61 të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), të miratuar më datë 04 nëntor 2017, në shqyrtimin gjyqësor publik, të mbajtur në praninë e palëve ndërgjyqëse, më datë 20 maj 2026, merr këtë:

AKTGJYKIM

I. Aprovohet e themeltë kërkesëpadia e paditësit: Nasuf Hasani, nga Prishtina, e paraqitur kundër të paditurës: Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK), me seli në Prishtinë.

II. Shpallet i paligjshëm dhe shfuqizohet paragrafi 2 i nenit 61 të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), të miratuar më datë 04 nëntor 2017.

III. Obligohet e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës t’ia kompensojë paditësit shumën prej 250 euro, pjesa tjetër e kërkesëpadisë për shpenzime përtej shumës së aprovuar refuzohet si e pa bazuar

V. Ky aktgjykim merr formën e prerë menjëherë pas komunikimit të përmbajtjes dhe arsytimit të tij palëve, dhe detyrohet e paditura Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK), me seli në Prishtinë, që të njëjtin ta publikojë në mënyrë të njëjtë sikurse të miratimit të aktit nënligjor normativ.

Arsyetim

I. *Historiku procedural dhe pretendimet e palëve ndërgjyqëse*



Paditësi: Nasuf Hasani, nga Prishtina, në Gjykatën Supreme të Kosovës, ka parashtruar padi kundër të paditurës: Oda e Avokatëve të Kosovës (OAK), me seli në Prishtinë, me bazë juridike: shfuqizimin e pjesshëm të aktit nënligjor normativ, paragrafit 2 të nenit 61 të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK).

Paditësi me padi, përgjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: Fillimisht e bëri precizimin e padisë, përkatësisht padia duhet të trajtohet vetëm së i përket shfuqizimit të nenit 61 paragrafi 2 i Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës të datës 04.11.2017, për faktin se kjo dispozitë është në kundërshtim të plotë me ligjin për avokatinë.

Ligji nr.04 L -m139 për Avokatinë është shpallur me datë 21.05.2013, ndërsa statuti i OAK-së është miratuar nga Kuvendi i OAK në mbledhjen e mbajtur më datë 04.11.2017, rrjedhimisht neni 61 par, 2 i Statutit të OAK, është në tërësi i kundërligjshëm, kur kemi parasysh se parasheh humbje automatike të së drejtës së ushtrimit të profesionit të avokatisë në rast se nuk paguhet anëtarësia vjetore në afatin e caktuar nga Këshilli Drejtues i OAK.

Vendimi i kontestuar të cilin nuk e kam pranuar asnjëherë nga OAK, është në kundërshtim me ligjin e Avokatisë, përkatësisht, neni 39 .par 1 nën par 1.10 i cili përcakton qartë se humbja e të drejtës për ushtrimin e avokatisë mund të ndodhë vetëm pas mos përmbushjes së detyrimeve financiare në periudhe 1 vjeçare, ndërkohë par 2 i nenit 62 të Statutit të OAK, parashikon humbje automatike të së drejtës, përkatësisht përbën tejkalim të autorizimit ligjor dhe shkelje të parimi të hierarkisë së akteve juridike. Për më tepër neni 61 par 2 i statutit të OAK, është në kundërshtim edhe me nenin 36 të kodit të etikes profesionale të avokatit, e cila dispozitë në mënyrë shprehimore e përkufizon mos pagesën e anëtarësisë vjetore si shkelje të rëndë, ndërkaq kur marrim parasysh normativën si tërësi të OAK dhe organet e saja, për një shkelje duhet të zhvillohet një procedurë administrative disiplinore. Mirëpo unë nuk kam pranuar asnjë vendim nga OAK-ja për humbjen e të drejtës së ushtrimit të profesionit të avokatisë. Theksoj se nga data 10 mars 2018 deri më datë 05 mars 2026 kam qenë kryetar i degës regionale të OAK në Prishtinë, rrjedhimisht edhe anëtar i Këshillit Drejtues të OAK-së, asnjëherë nuk iu kam shmangur obligimeve të Odës sepse jam shumë i vetëdijshëm se duhet të paguhet anëtarësia, mirëpo me përgjegjësi e pohoj se asnjëherë Këshilli Drejtues nuk ka marrë një vendim të tillë, sepse personalisht kame qenë i kujdesshëm që çdo vendim i marrë nga Këshilli Drejtues i OAK-së të merret duke u bazuar nga ligji i avokatisë, statuti dhe normatives ligjore si tërësi. Anëtarësinë vjetore e kam paguar brenda afatit ligjor që 11 vite, madje e kam paguar edhe përpara për vitin pasues, sikurse dëshmohet nga kjo faturë, për vitin



2025 kam paguar në vitin 2024 dhe nuk më ka ndodhur asnjëherë që t'iu ike obligimeve sipas ligjit për avokatin . Duke marrë këtë vendim të kundërligjshëm më janë shkaktuar pasoja të pariparueshme, kam shtyrë seanca më kanë refuzuar palët të cilët më kanë autorizuar paraprakisht, krejt këto si rezultat i veprimeve autokratike, të papërgjegjshme të një kryetari të OAK-së, i cili ushtrimin e profesionit të avokatit e ushtron në kundërshtim me normativën e OAK-së dhe ligjin e avokatisë. Andaj në kuptim të pretendimeve dhe thënjeve si në kërkesëpadi Gjykatës Supreme me respekt i propozoj të konstatoj se neni 61 par 2 i statutit të OAK- së është në kundërshtim me ligjin e avokatisë, në kundërshtim me parimet kushtetuese të përcaktuara në kushtetutën e RKS-së, rrjedhimisht të shfuqizohet neni 61 par 2 statutit, për arsye se sa i përket detyrimeve financiare, përkatësisht pagesës së anëtarësisë vjetore janë të përcaktuara me ligjin e avokatisë, përkatësisht afati i përcaktuar me ligjin e avokatisë ka përparësi ndaj afateve të përcaktuara me Statutin e Odës, kërkoj që të detyrohet e paditura t'i paguaj shpenzimet e procedurës, për taksë shumë 250 euro , për përpilimin e padisë 160 €, dhe për një seancë shumë prej 208 €, në lartësi të përgjithshme prej 618 €.

Në vazhdim ka theksuar se: Vlen të theksohet se, nga data 10 mars 2018 deri më datë 5 mars 2026, ka pasur funksionin e Kryetarit të Degës Regjionale në Prishtinë, rrjedhimisht edhe anëtar i Këshillit Drejtues të Odës së Avokatëve të Kosovës, asnjëherë për këto 8 (tetë) vite, por as para datës 5 mars 2018, Këshilli Drejtues i Odës së Avokatëve nuk e ka caktuar ndonjë afat për ta paguar anëtarësinë vjetore, nga se në këtë rast, sa i përket kësaj çështjeje, afati i pagesës është i përkufizuar në Ligjin Nr. 04/L-193 për Avokatinë, përkatësisht neni 39 paragrafi 1 nën paragrafi 1.10 shprehet: avokati e humb të drejtën për ushtrimin e profesionit vetëm nëse nuk i përmbush detyrimet financiare ndaj Odës për një periudhë të plotë prej një (1) viti. Me datë 08 prill 2026, përmes postës nga Oda e Avokatëve të Kosovës, ka pranuar parashtrësën me titull “akt administrativ” (me karakter konstatues), me Nr. 124/2026 të datës 01 prill 2026. Ky akt i nënshkruar nga Besnik R. Berisha, si në dispozitivin II citohet se konstatohet se “si pasojë e mosplotësimi të pagesës së anëtarësisë vjetore ka humbur të drejtën e ushtrimit të profesionit të avokatisë”, njëkohësisht në dispozitivin III citohet se: Ky akt administrativ ka karakter konstatues dhe deklarativ dhe paraqet zbatim të drejtpërdrejtë të dispozitave statutare dhe Vendimit të Këshillit Drejtues. Pra, mbi të theksimet si më lart, përveç se nuk ka pranuar asnjë vendim nga Oda e Avokatëve të Kosovës, me të cilin humbet e drejta e ushtrimit të profesionit të avokatit, përveç të ashtuquajturit Akt Administrativ me Nr. 124/2026 të datës 01 prill 2026, nga i cili konstatohet se për shkak se nuk ka përmbushur detyrimin e pagesës së anëtarësisë vjetore për vitin 2026 brenda afatit përfundimtar të caktuar



më datë 31 mars 2026, me qenë se këto veprime tani më kanë prodhuar pasoja të drejtpërdrejta në kufizimin e profesionit, përbëjnë pasoja për mirëqenien time dhe të familjes time, prodhojnë pasoja për palët që i përfaqësoj për çdo ditë në gjykatë dhe prokurori, me këto veprime Besnik R. Berisha kundërligjshëm ka vepruar. Sipas Draft-Rendit të Ditës së mbledhjes së 251-të të Odës së Avokatëve të Kosovës, të mbajtur më 06.03.2026, çështja e pagesës së anëtarësisë vjetore nuk ka qenë asnjëherë e parashikuar si pikë diskutimi. Në mënyrë arbitrare dhe jashtë kompetencës, Besnik R. Berisha e ka futur këtë çështje në rendin e ditës, duke shkelur qartë dispozitat statutare dhe ligjore. Megjithatë, duke vepruar në mënyrë jashtëligjore dhe jashtë kompetencës, Besnik R. Berisha nga cilësia e Kryetarit të Odës së Avokatëve të Kosovës ka vendosur një afat të shkurtër deri më 31.03.2026 për pagesën e anëtarësisë vjetore për vitin 2026, duke krijuar pasoja të drejtpërdrejta për ushtrimin e profesionit tim. Ky veprim ka pasoja ekzistenciale për mua dhe familjen time, duke më penguar të ushtroj profesionin, të përfaqësoj klientët e mi dhe duke cenuar të ardhurat dhe stabilitetin e jetës familjare. Tani më, kam presion nga klientët rreth këtyre rrethanave të krijuara. Ky veprim përbën shkelje të rëndë të parimit të ligjshmërisë, hierarkisë së akteve juridike dhe të drejtës kushtetuese për ushtrimin e profesionit sipas Nenit 49 të Kushtetutës së Kosovës. Ai përbën veprim jashtë kompetencës zyrtare dhe ka prodhuar pasoja juridike të paligjshme, duke cenuar të drejtat e mia si avokat dhe sigurinë juridike të klientëve që përfaqësoj. Ky veprim i Besnik R. Berisha bie ndesh me parimin themelor të hierarkisë normative, për faktin se në rastin konkret, akti-vendimi (të cilin nuk e kam pranuar asnjëherë) mbështetet në nenin 61 paragrafi 2 të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës, i cili parasheh se në rast të mospagesës së detyrimeve financiare brenda afatit të përcaktuar nga Oda, avokatit i humb automatikisht e drejta për ushtrimin e avokatisë dhe shlyhet nga regjistri i avokatëve. Me këtë akt normativ nënligjor është cenuar rendi juridik i përcaktuar sipas fuqisë së akteve juridike: 1) Kushtetuta, 2) Ligji dhe 3) aktet nënligjore (statute, udhëzime administrative, rregullore, vendime), sepse me aktin nënligjor Statutin më është kufizuar në kohë e drejta prej një (1) viti për ta paguar anëtarësinë vjetore për vitin 2026. Për këto 11 vite e më shumë që e ushtroj profesionin e avokatit, ka ndodhur shumë shpesh se e kam paguar anëtarësinë vjetore në fund të çdo viti, edhe një herë po e ritheksoj, asnjëherë deri tani nuk është marrë ndonjë vendim i ngjashëm nga ana e Këshillit Drejtues të Odës së Avokatëve.

Me akt nënligjor nuk mund të vendosen kushte shtesë, nëse këto kushte nuk parashihen me ligj, pra me këtë akt nënligjor - Statutin e Odës së Avokatëve të Kosovës është cenuar siguria juridike, duke shkaktuar diskriminim arbitrar si paditës me cenimin e të drejtës së fituar më



ligj për ushtrimin e profesionit të avokatit, rrjedhimisht një e drejtë e garantuar me ligj nuk mund të më mohohet me akt normativ nënligjor të nxjerrë më vonë, si në rastin konkret. Po ashtu, këto veprime bien ndesh edhe me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 51, sipas të cilit një akt administrativ prodhon pasoja juridike vetëm pas njoftimit të rregullt të palës, si dhe me nenin 9, i cili garanton parimin e transparencës dhe të drejtën e palës për t'u njoftuar me aktet që prekin të drejtat e saj/tij. Për më tepër, veprimet janë në kundërshtim edhe me nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili garanton të drejtën për punë dhe ushtrimin e profesionit. Këto veprime janë ndërmarrë me qëllim të drejtpërdrejtë të eliminimit dhe dëmtimit tim, për shkak të kritikave të hapura kundrejt Besnik R. Berisha në aspektin e menaxhimit të Odës së Avokatëve të Kosovës, duke synuar kufizimin dhe pamundësimin e ushtrimit të profesionit tim, dëmtimin e reputacionit profesional dhe cenimin e marrëdhënieve të mia me klientët dhe institucionet, duke krijuar një gjendje faktike të kryer pa bazë ligjore dhe pa procedurë të rregullt. Me këto veprime, më është cenuar e drejta për ushtrimin e mjetit juridik efektiv, duke privuar nga mundësia për të pranuar një vendim formal dhe për të ushtruar ankesë, si dhe ka parapërcaktuar rezultatin e një procedure që nuk është zhvilluar në përputhje me ligjin.

Edhe sa i përket vendimi të datës 06 mars, në të cilin është caktu afati për pagesën e anëtarësisë vjetore për vitin 2026, kjo çështje nuk ka qenë fare në rend të ditës, e kanë kundërshtuar anëtarët e këshillit drejtues Blerim Ademaj dhe Admir Salihu, kanë potencuar së paku 3 ose 4 here se është në kundërshtim të plot me ligjin e avokatisë. Asnjëherë nuk është marrë nga Këshilli Drejtues një vendim i tillë, pra kjo ka ardh si rezultat i kritikave të mia se si po menaxhohet oda nga ky kryetar, si hakmarrje e pastër, gjë që edhe kam paraqitë kallxim penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë, dhe më është mohuar e drejta e ankesë sipas nenit 43 të Kushtetutës së RKS, dhe komisioni i ankesave është përfundimtar në vendimmarrje sipas nenit 6 të Ligjit të Avokatisë. Prandaj ju propozoj që të konstatohet se neni 61 par 2 i statutit të OAK- së është në kundërshtim me ligjin e avokatisë, dhe iu propozoj që i njëjti të shfuqizohet.

Gjykata me aktvendimin e datës 16.04.2026, ka njoftuar të paditurën lidhur me padinë e ushtruar, dhe pretendimet për paligjshmërinë e aktit normativ të kontestuar nga paditësi, si dhe detyrimin për paraqitjen e dosjes së plotë të procedurës administrative dhe të gjitha dokumenteve që kanë të bëjnë me lëndën e çështjes. Gjithashtu, gjykata i ka informuar palët



për të drejtat, detyrimet dhe pasojat juridike që lidhen me veprimet procedurale në këtë çështje të konfliktit administrativ, duke u dorëzuar një kopje të padisë, së bashku me provat përkatëse të bashkëngjitura nga paditësi.

Përfaqësuesi i të paditurës Kryetari i Odës së Avokatëve të Kosovës z.Besnik Berisha në seancë ka dorëzuar përgjigjen me shkrim dhe ka deklaruar: Çështja që kemi pranë vetes për trajtim është një ftesë e pastër për ndërhyrje gjyqësore për një organ me kategori kushtetuese, që autonominë e ka të garantuar me Kushtetutë, ligj dhe me rregullin juridik të secilit shtet demokratik. Ndonëse padia e parashtruar përshkruan pakënaqësi individuale e jo argumente që flasin për papërshtatshmëri ligjore, edhe pse u bë precizicimi, i gjithë rrëfimi ishte në kuadër të kësaj pakënaqësie, megjithatë duke respektuar mandatin ligjor edhe kushtetues të kësaj gjykate ne po koncentrohemi vetëm te përshtatshmëria e normës statutoire me ligjin. Për ta sqaruar këtë pjesë më qartë , duhet t'i referohemi praktikës se si regjistrohet një avokat në OA. Kjo praktikë e mbështetur tërësisht në ligj përcakton se para se avokati të japë betimin si anëtarë i OAK-së dhe të regjistrohet në regjistrin publik, ai ose ajo ka për detyrim të paguajë të gjitha detyrimet financiare përfshirë dhe pagesën për anëtarësi vjetore. Pagesa për anëtarësi vjetore është çështje avansi, pra nuk është faturë pas kryerjes së një shërbimi 1 vjeçar. Në secili vit vijues paraprakisht lëshohet një urdhër pagese dhe avokati obligohet të paguajë anëtarësinë, në të kundërtën nuk ka status aktiv, nuk mund të pajiset me kartelë të avokatit dhe rrjedhimisht nuk mund ta shmangë këtë detyrim nëse donë të mbetet në listën e avokatëve. Paditësi tha se në vitin 2024 kam paguar për vitin 2025, ndërkaq në vitin 2026 parashtron se ka afat deri në fund të vitit 2026 sipas ligjit. Kjo nuk është fryma e ligjit, sepse po të interpretohej kështu do të nënkuptonte se një avokat paguan njëherë me rastin e regjistrimit, mbetet aktiv për një vit, pastaj në vitin tjetër tek në fund të vitit mund të rezultoj një pasojë, e që i bie se anëtarësia qenka një herë në 2 vjet e jo një pagesë që bëhet avans për secilin vit vijues. Neni 39 par 1 pika 1.10 parasheh një nga format e humbjes së të drejtës për ushtrimin e profesionit, sepse në nenin 38 të ligjit parashihet ndërprerja vullnetare e ushtrimit të profesionit por edhe në mënyrë automatike kur ndaj avokatit janë inicuar procedura si penale, disiplinore, etj, ndërkaq par 1.4 parasheh shkaqet e arsyeshme për mos ushtrimin e profesionit. Neni 37 parasheh pezullimin e ushtrimit të profesionit, e që të 3(tri) këto norma bashkë nëse krahasohen me normat statutoire, rezulton se këto të fundit janë në përshtatshmëri të plotë. Gjuha në nenin 39 par 1 pika 1.10, nuk është siç u referua këtu, por saktësisht përcakton se “në periudhë prej 1 viti nuk i përmbush detyrimet financiare ndaj odës”, ndërkaq neni 61 i Statutit përcakton se: afati për pagesën e anëtarësisë përcaktohet nga Oda dhe par 2 që



kërkohet të shfuqizohet përcakton se në rast të mos pagesës në përputhje me afatin që përcakton Oda humb e drejta e ushtrimi të profesionit. Pra ligji nuk e përcakton se një detyrim ndaj OAK-së mund të rrijë pezull 1 vit që në praktikë i bie 2 vite, e tek atëherë të prodhohen pasoja për avokatin, sikurse kjo normë nuk adreson vetëm çështjen e pagesës së anëtarësisë, por edhe detyrimet tjera financiare që avokatët për shkak të procedurave disiplinore apo të ngjashme kanë në vazhdim. Për ta kuptuar logjikën e normës duhet një interpretim sistematik i disa dispozitave ligjore dhe jo i një paragrafi, nën paragrafi, në shpërputhje të plotë me frymën e ligjit. Për korrektësi këto norma siç ka thënë Skënderbeu: lirinë e gjeta këtu nuk e solla unë, janë miratu, zbatu gjatë gjithë kohës dhe asnjëherë nuk janë vu në pikëpyetje e as kundështu, përfshirë vet paditësin që ka qenë në organe udhëheqëse të OAK-së. Gjithsesi si OAK jemi kundër arbitraritetit, kundër anarkisë dhe pro zbatimi të ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë në këtë vend. Meqë në përgjigje në padi kemi parashtruar argumente për secilin pretendim, përfshi edhe kërkesën që të mos trajtohet pjesa ku kërkohet anulimi i vendimit dhe kthimi i paditësit në regjistrin e avokatëve, për të shmangur përsëritjet dhe ekonomizuar kohën e kolegjit apelojmë të këto të trajtohen në vijim të argumenteve të parashtruara si pjesë e argumenteve plotësuese. Sot besoj që secili ka pas pritshmëri që do të ofroheshin argumente, shembuj e praktika se norma statutore për vlerësim ishte dhe është në thelb në kundërshtim me ligjin, por në mungesë të këtyre argumenteve, të cilat janë kryesisht barrë e paditësit, parashtrimet tona përfundimtare me respekt reflektojnë vetëm ato çfarë i kemi shkruar në përgjigje në padi, në frymën e normave ligjore dhe kushtetuese, dhe praktikës së GJEDNJ-së në raport me pavarësinë e organizatave siç është OAK-ja dhe praktikat tjera ndërkombëtare që mbrojnë pavarësinë dhe i japin të drejtë të plotë sovranitetit vetregullues të një organizate si ODA. Natyrisht kjo nuk është ftesë që gjykata ta injoroj ligjin po është kërkesë me respekt që të zbatohet ligji dhe jo vetëm ai material që keni në trajtim tani, por edhe ligji procedural që përcakton formën dhe mënyrën se si një kontroll abstrakt iniciohet, si argumentohet dhe kush ka për detyrim të argumentoj çfarë. OAK-ja ka rreth 1500 anëtarë të cilët besojnë fuqishëm në sovranitetin e saj, promovojnë dhe avansojnë vlera e parime që reflektojnë në ligj në Kushtetutë dhe jo vetëm. Me respekt parashtrojmë se paditësi me asnjë argument nuk arrinë të provoj pa përshtatshmërinë e normës statutore me normën ligjore. Sërish, ndihem keq për kohen dhe përpiqem ta mbyll shpejtë, i besojmë fuqishëm vlerësimin tuaj, asgjë në këta rreshta të statutit nuk është personale e askujt dhe si aleat të sistemit të drejtësisë i nënshtrohemi ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë dhe jemi të lumtur të kontribuojmë që secila normë e ligjit të reflektohet në secilën normë të akteve tjera që janë përgjegjësi ekskluzive e OAK-së ti nxjerr dhe publikoj. apelojmë që padia në raport me pjesën



e kundërshtimi të vendimeve të reflektoj precizimin që u bë, ndërkaq pjesë kontestuese të normës të refuzohet si e pathemeltë, duke konstatuar se neni 61 par 2 i statutit të OAK-së, nuk kufizon të drejta më shumë se ato që i jep ligji dhe nuk është në papërshtatshmëri ligjore e as kushtetuese si normë e përgjithshme. Kjo normë nuk i merr askujt licencën, thjeshtë përcakton rrugë, ka qartësi, parashikueshmëri dhe është në linjë të plotë me frymën e dispozitave ligjore të Ligjit për avokatinë duke filluar nga neni 3 e përfunduar në nenin 46 ku pagesën e anëtarësisë e konsideron detyrim ligjore jo fakultativ siç është paraqitur në padi.

II. Vlerësimi i gjendjes faktike dhe provat e administruara

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave në seancën e shqyrtimit gjyqësor - publik të datës 20.05.2026, ka administruar provat relevante dhe atë: Statuti i Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK); Komunikimi me email, i datës 9 mars 2026, 16 mars 2026 dhe 7 prill 2026; Njoftim për humbjen e së drejtës për ushtrimin e profesionit të avokatit, nr. 131/2026, të datës 02.04.2026; akt administrativ nr.124/2026, i datës 1 prill 2026; Kopje nga llogaria rrjedhëse në Bankën Ekonomike; Procesverbal i seancës së dëgjimit C.nr.4371/2025, datë 16.04.2026; Draft - Rendi i ditës, datë 06.03.2026; Vendim nr.93/2026, datë 06.03.2026.

Gjykata në pajtim me dispozitat ligjore të nenit 59 paragraf 8 të Ligjit nr.08/L-182 për Konfliktet Administrative, i publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 10.01.2024, dhe ka hyrë në fuqi më datë 10.01.2025 (më tutje: LKA), ka shqyrtuar padinë dhe kërkesëpadinë në drejtim të thënieve në padi, thënieve në seancë dhe pas shqyrtimit të shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ ka vlerësuar se:

Kërkesëpadia e paditësit është e themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se: Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës në mbledhjen e mbajtur me datë 04 nëntor 2017, ka aprovuar Statutin e Odës së Avokatëve të Kosovës.

Me këtë Statut rregullohen: e drejta për ushtrimin e avokatisë, praktikantët dhe anëtarët vullnetar, regjistrat e Odës së Avokatëve të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Oda), të drejtat dhe detyrat e avokatëve, organizimi i brendshëm i Odës dhe shtrirja regjionale e Odës, përgjegjësia disiplinore e avokatëve dhe e praktikantëve, specializimi i avokatëve, afarizimi financiar, administrata e Odës, çështjet tjera të rëndësishme për rregullimin e avokatisë dhe organizimin e Odës.



Aktin nënligjor normativ të kontestuar, e paditura e ka nxjerr në mbështetje të nenit 41 par. 3 pika 3.4, dhe nenin 42 par. 2 të Ligjit për Avokatinë Nr. 04/L-193.

Pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, procedimit dhe vlerësimit të provave materiale të paraqitura nga palët ndërgjyqëse, Gjykata konstaton se pretendimet e paditësit, të parashtruara me padinë janë të bazuara.

III. Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare më datë 09.04.2008, dhe ka hyrë në fuqi më 15.06.2008

Neni 102 [Parimet e Përgjithshme të Sistemit Gjyqësor], paragraf 3 përcakton: “Gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”.

Ligji Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative, Gazeta Zyrtare Nr.3, i miratuar më 14 dhjetor 2023, dhe në fuqi nga data 10 janar 2025

Neni 3 [Përkufizimet]: “1. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime: 1.1. Akt nënligjor normativ - një akt, i nxjerrë në bazë të autorizimit të shprehur të një ligji të miratuar nga Kuvendi, që përcakton rregulla të detyrueshme sjellje në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme”.

Neni 5 [Parimi i ligjshmërisë]: “Gjykata kompetente shqyrton konfliktin dhe vendos në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”.

Neni 10 [Organizimi dhe Kompetenca]: “4. Gjykata Supreme, gjykon revizionin dhe si shkallë e parë dhe e vetme, padinë për shfuqizimin e një akti nën-ligjor normativ”.

Neni 11 [Përbërja në gjykim]: “3. Gjykata Supreme, gjykon lëndën në kolegji të përbërë prej tre (3) gjyqtarësh”.

Neni 13 [Llojet e padive]: “1. Në konfliktin administrativ, paditësi mund të kërkojë: 1.6. shfuqizimin e një akti nënligjor normativ (në tekstin e mëtejme “padia ndaj aktit nënligjor normativ”).

Neni 25 [Padia për shfuqizimin e aktit nënligjor normativ], “1. Me padinë për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ, paditësi kërkon deklarimin e paligjshmërisë të një dispozite të një akti nënligjor normativ apo të tërë aktit nënligjor normativ në tërësinë e tij dhe përkatësisht shfuqizimin e tyre. 2. Padia për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ mund të ngrihet nëse



një person fizik apo juridik pretendon se akti është në kundërshtim me ligjin dhe se për këtë shkak i cenon apo do ti cenojë në të ardhmen, të drejtat apo interesat e tij të ligjshëm. 5. Në padinë kundër aktit nënligjor normativ, i paditur, është organi publik që ka miratuar aktin. 7. Padia për shfuqizimin e një akti nënligjor normativ paraqitet në çdo kohë për sa akti është në fuqi, madje edhe pas miratimit por para publikimit të detyrueshëm të aktit, për efekt të hyrjes të tij në fuqi”.

Neni 58 [Përmbajtja e padisë me objekt shfuqizimin e aktit nënligjor normativ]: *“Në zbatim të nenit 33 të këtij Ligji, padia me objekt shfuqizimin e një akti nënligjor normativ duhet të specifikoj ndër të tjera, nëse i tërë akti i kontestuar apo dispozita të veçanta të këtij akti konsiderohen të jenë në kundërshtim me ligjin dhe kundërshtimet e ngritura kundër ligjshmërisë të tyre.”*

Neni 59 [Procedimi i padisë me objekt shfuqizimin e aktit nënligjor normative]: *“8. Në shqyrtimin e themelësisë së padisë, Gjykata vlerëson përmbajtjen, formën dhe procedurën për miratimin, shpalljen dhe hyrjen në fuqi të aktit nënligjor normativ të kontestuar.”*

Ligji Nr. 04/L-193 për Avokatinë, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 20 / 31 Maj 2013, Prishtinë

Neni 39 [Humbja e të drejtës për ushtrimin e avokatisë]: *“1. Avokati e humb të drejtën për ushtrimin e avokatisë, nëse: 1.10. në periudhë prej një (1) viti nuk i përmbush detyrimet financiare ndaj Odës.”*

Statuti i Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), 04 nëntor 2017

Neni 61: *“1. Avokati është i detyruar ti përmbush të gjitha obligimet financiare të përcaktuara nga organet dhe aktet normative të Odës . 2. Në rast të mos pagesës të obligimeve nga paragrafi 1 i këtij neni, në afatin e përcaktuar nga Oda, avokatit në mënyrë automatike i humb e drejta e ushtrimit të avokatisë dhe shlyhet nga Regjistri i avokatëve. Vendimin për humbjen e së drejtës së ushtrimit të avokatisë dhe shlyerjes nga Regjistri i avokatëve e nxjerrë Këshilli Drejtues me propozimin e Drejtorit Ekzekutiv. 3. Vendimi për humbjen e së drejtës së ushtrimit të avokatisë dhe shlyerjes nga Regjistri i avokatëve nga par.2 i këtij neni shpallet në ueb-faqen e Odës dhe për këtë vendim informohen institucionet përkatëse.”*

IV. Vlerësimi i gjykatës mbi pretendimet e padisë dhe kërkesëpadisë së paditësit



Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, duke shqyrtuar në mënyrë të gjithanshme pretendimet e palëve ndërgjyqëse, provat e administruara dhe dispozitat kushtetuese e ligjore të aplikueshme, vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë në pjesën që i referohet ligjshmërisë së dispozitës së kontestuar të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës, përkatësisht nenit 61 paragrafi 2 të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), të miratuar më datë 04 nëntor 2017.

Gjykata fillimisht thekson se neni 102 paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton qartë se “gjykatat gjykojnë në bazë të Kushtetutës dhe ligjit”, duke vendosur kështu parimin themelor të ligjshmërisë dhe hierarkisë normative si kriter vendimtar për vlerësimin e çdo akti juridik, përfshirë edhe aktet nënligjore normative të nxjerra nga organet e administratës publike si: Oda e Avokatëve të Kosovës.

Vlerësimi i ligjshmërisë së statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës në procedurën sipas konfliktit administrativ nuk përbën ndërhyrje në pavarësinë funksionale të palës së paditur Odës së Avokatëve të Kosovës, pasi Gjykata Supreme ka juridiksion të vlerësoj secilin akt nënligjor të secilit institucion publik sipas padisë së palës në konflikt administrativ konform dispozitave ligjore, madje vlerësimi i ligjshmërisë së akteve nënligjore siguron funksionim autonom por brenda kornizës ligjore në fuqi. Vlerësimi i ligjshmërisë së akteve nënligjore nuk e cenon pavarësinë funksionale të palës së paditur.

Në këtë kontekst, Gjykata vlerëson se Ligji Nr. 04/L-193 për Avokatinë, në nenin 39 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10, përcakton në mënyrë të qartë dhe taksative se “*avokati e humb të drejtën për ushtrimin e avokatisë nëse, në periudhë prej një (1) viti nuk i përmbush detyrimet financiare ndaj Odës*”. Ky formulim ligjor është i karakterit kufizues dhe i detyrueshëm, duke vendosur një standard minimal kohor prej një viti si kusht material për lindjen e pasojës juridike të humbjes së të drejtës për ushtrimin e profesionit.

Nga ana tjetër, neni 61 paragrafi 2 i Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës parasheh se “*në rast të mos pagesës së obligimeve në afatin e përcaktuar nga Oda, avokatit në mënyrë automatike i humb e drejta e ushtrimit të avokatisë dhe shlyhet nga Regjistri i avokatëve*”. Kjo dispozitë, e lexuar në tërësinë e saj, i jep organit të administratës Odës së Avokatëve të Kosovës kompetencë diskrecionale për të përcaktuar afatin brenda të cilit duhet të kryhet pagesa, duke mos e lidhur më këtë afat me kufirin ligjor prej një viti të përcaktuar në mënyrë eksplicite nga ligji.



Gjykata vlerëson se një rregullim i tillë nënligjor krijon një standard juridik të ndryshëm dhe më të ashpër sesa ai i përcaktuar me ligj, duke e zhvendosur momentin juridik të lindjes së pasojës nga një afat i caktuar me ligj në një afat të përcaktuar me akt nënligjor. Në këtë mënyrë, Statuti nuk kufizohet në operacionalizimin e ligjit, por e ndryshon përmbajtjen materiale të tij, çka nuk është në pajtim me parimin e hierarkisë së akteve juridike. Statuti nuk e duplifikon dispozitën sikurse ka raste kur e njëjta përmbajtje e dispozitës ligjore është edhe në akt nën ligjor, që nuk do të përbënte problem apo diskrepancë pasi do të ishte duplikim por në rastin konkret hapësira që i ipet në vendosje të afatit Odës së Avokatëve me Statut nuk është në përputhje me ligjin më konkretisht me dispozitën ligjore nga neni 39 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10, pasi bëhet fjalë për afat ligjor dhe prag minimal që nuk mund të ndryshohet e as të ketë diskrecion përveç përmes ndryshimeve ligjore.

Në kuptim të Ligjit Nr. 08/L-182 për Konfliktet Administrative, neni 3 përcakton se akt nënligjor normativ është vetëm ai akt që *“përcakton rregulla të detyrueshme sjelljeje në mënyrë abstrakte dhe të përgjithshme, në bazë të autorizimit të shprehur të ligjit”*. Ky definim nënkupton se akti nënligjor mund të veprojë vetëm brenda kufijve të autorizimit ligjor, pa e tejkaluar atë dhe pa ndryshuar ekuilibrin normativ të vendosur nga ligjvënësi.

Në këtë rast konkret, Gjykata konstaton se Ligji për Avokatinë nuk i ka deleguar Odës së Avokatëve kompetencë për të përcaktuar afate më të shkurtra apo kushte më të rënda sesa ato të parapara me nenin 39 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10. Përkundrazi, ligji ka përcaktuar në mënyrë shprehimore një periudhë njëvjeçare si kusht material për humbjen e së drejtës profesionale, duke e bërë këtë rregullim të detyrueshëm dhe të pacenueshëm nga aktet nënligjore.

Prandaj, dispozita e nenit 61 paragrafi 2 të Statutit, në pjesën ku parashikon humbjen *“automatike”* të së drejtës për ushtrimin e avokatisë në bazë të një afati të përcaktuar nga Oda, krijon një regjim juridik të pavarur nga ligji dhe në kundërshtim me të, duke cenuar parimin e sigurisë juridike dhe parimin e ligjshmërisë.

Gjykata thekson se parimi i sigurisë juridike kërkon që subjektet juridike të jenë të afta të parashikojnë me një shkallë të arsyeshme sigurie pasojat juridike të veprimeve të tyre. Në këtë rast, ndryshimi i afatit material për humbjen e së drejtës profesionale nga ligji në statut, dhe delegimi i tij në diskrecion administrativ të Odës, krijon pasiguri juridike dhe cenon pritshmëritë legjitime të avokatëve si subjekte të së drejtës publike profesionale.



Po ashtu, Gjykata vlerëson se e drejta për ushtrimin e profesionit, e garantuar me nenin 49 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, mund të kufizohet vetëm me ligj dhe në përputhje me parimet e proporcionalitetit dhe domosdoshmërisë. Çdo kufizim shtesë i vendosur me akt nënligjor, pa autorizim të qartë ligjor, përbën tejkalim të kompetencës normative dhe ndërhyrje të palejuar në të drejtën kushtetuese.

Në këtë drejtim, Gjykata vëren se dispozita e kontestuar nuk është vetëm rregullim teknik i procedurës së pagesës së anëtarësisë, por krijon pasojë juridike të drejtpërdrejtë, humbjen e së drejtës për ushtrimin e profesionit dhe shlyerjen nga regjistri i avokatëve, pa respektuar kufirin kohor dhe kushtin material të përcaktuar me ligj. Kjo e bën dispozitën të papajtueshme me hierarkinë normative dhe jashtë autorizimit ligjor.

Rrjedhimisht, Gjykata përfundon se neni 61 paragrafi 2 i Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës është në kundërshtim me nenin 39 paragrafi 1 nënparagrafi 1.10 të Ligjit Nr. 04/L-193 për Avokatinë, si dhe me parimin kushtetues të ligjshmërisë dhe hierarkisë së akteve juridike, dhe si i tillë duhet të shfuqizohet.

Vlerësimi i gjykatës mbi kërkesat akcesore

Lidhur me shpenzimet e procedurës:

Sa i përket shpenzimeve të procedurës, Gjykata vendosi si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 463 të LPK-së, i cili parasheh “463.1 Për pagimin e shpenzimeve procedurale gjykata vendosë vetëm me kërkesën e specifikuar të palës, pa bërë asnjë shqyrtim verbalisht lidhur me kërkesën. 463.2 Pala ka për detyrë që në kërkesën e saj në mënyrë të specifikuar t’i tregoj shpenzimet për të cilat kërkon shpërblim, duke parashtruar prova për shpenzimet e bëra, po që se nuk ekzistojnë provat e tilla në dosjen e lëndës. 463.3 Pala duhet ta paraqes kërkesën për pagimin e shpenzimeve më së voni deri në përfundimin e shqyrtimit që i paraprinë vendosjes mbi shpenzimet, e po që se është fjala për dhënien e vendimit pa u bërë shqyrtim paraprakisht, atëherë pala ka për detyrë që kërkesën për shpenzimet e procedurës ta parashtojë në propozimin mbi të cilin gjykata duhet të vendosë. 463.4 Për kërkesën e palës për pagimin e shpenzimeve të procedurës, gjykata do të vendosë në aktgjykimin ose aktvendimin me të cilin përfundon procedura përpara kësaj gjykate. 463.5 Gjatë zhvillimit të procedurës gjykata vendosë me aktvendim të veçantë për pagimin e shpenzimeve të procedurës vetëm atëherë kur e drejta e shpërblimit nuk varet fare nga vendimi mbi çështjen kryesore”. Meqenëse paditësi i ka specifikuar shpenzimet e procedurës, statusi momental i paditësit nuk është avokat, padinë e ka hartuar vetë dhe jo të avokati, përfaqësimin





GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Sheji i shkresës: P.A.-09/2026
Oznaka spisa:

FLETËDËRGESË PËR DORËZIM PERSONAL DQSTAYNICA ZA LICNO DOSTAVLANJE

QDA E AVOKATIT TE KOSOVES PRISHTIA

1. Pasi marrësi, i cili me tentimin e parë të dorëzimit nuk u gjet në vendin e ku është dashtë të bëhet dorëzimi, i sa pas lënies së lajmërimit me shkrim që për shkak të dorëzimit të gjendet në kohën e caktuar në banesën apo në vendin e punës së tij, dorëzimi është bërë: anëtarit mëdhor të familjes së marrësit - kujdestarit të ndërtesës, fqit, personit që punon po në atë vend me marrësin.

1. Posto primitac, koji pri prvom pokušaju dostave nije zatecen na mestu gde se dostavljanje ima izvršiti ni posle ostavljenog pismenog obaveštenja da radi dostavljanja bude u određeno vreme u svom stanu radnom mestu, dostava je izvršena; odraslom članu domaćin. Primaoca nastojniku zgrace susedu licu zaposlenom na istom radnom mestu primaocem

2. Pasi marrësi ose anëtar i familjes së tij e refuzon marrjen e shkresës, shkresa u la në banesë në vendin e punës së marrësit (dike e ngjitur në derën e banesës ose të lokalit ku gjendet në punë marrësi).

2. Posto primitac odnosno član njenog domaćinstva odbio prijem, pismo je dostavljeno u stanu - radnom mestu primaoca (pribieno na vratima stana odnosno prostorije gde primitac zaposlen)

Më _____ 201____ në ora _____ cas.
dana _____ u _____

Shikaku i refuzimit të marrjes
Razlog adhbijanja prijmea _____

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

Emri i shkresës që dorëzohet:

Naslov pisma koja se dostavlja:

AKT GJYKIM 20.05

2026

Numri i shtojcave: 1

broj priloga

Vërtetoi se mora shkresën e lartpërmendur
më (me fjalë)

Povrdujemo prijem gorenavegenog pisma
(i slovinia)

26.05.2026

(Nënshkrimi i marrësit ose i atij që
e ka marrë aktin në vend të tij
Popis primoca ili lica koje je
pismeno primilo u zaimenu)

Nënshkrimi i dorëzuesit - potpis dostavljaca

(Të panevojshmeve bjeri vizë - nepotrebn precrati)

Në rast se marrësi është analfabet ose nuk është në gjendje të nënshkruajë dorëzuesi, duke shkruar shkrimin për marrësi nuk e ka vënë nënshkrimin e vet. Ako je primitac nepismen ili nije u stanju da se potpiše, potpisuje ga dostavljač. Napomenom zaslo primitac nije stavio svoj potpis.